



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.2, Tiranë; Tel: 04251-26 E-mail: klsh.org.al; ëeb-site:ëëë.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M
Nr. 95, Datë 30/09/2019

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË
MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT (DRISHMPUT)
QARKU FIER "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË SË AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR",
për periudhën nga data 01.10.2016 deri më datën 01.10.2018

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin ekonomiko- financiar, për kryerjen e inspektimeve lidhur me zbatimin e kontrollin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit të mbrojtjes së mjedisit e pyjeve*" të ushtruar në DRISHMPUT Fier me programin e auditimit nr.1278/1, datë 16.11.2018 për periudhën 01.10.2016 deri më 01.10.2018.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI AUDITIMIT

Baza për opinionin (ISSAI 400¹):

KLSH ka audituar veprimtarinë e DRISHMPUT Qarku Fier në mbështetje të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700 dhe ISSAI 4000.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga DRISHMPUT Qarku Fier dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Menaxhimi i DRISHMPUT është përgjegjësi për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH –së nëpërmjet auditimit të realizuar në DRISHMPUT Qarku Fier, krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*) dhe konsistojnë si më poshtë:

1. Nga auditimi financiar: Në mbajtjen e kontabilitetit, përgjithësisht janë aplikuar në mënyrë të drejtë rregullat kontabël.

Opinion:

Nga ***auditimi i pasqyrave financiare***, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, porsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti DRISHMPUT Qarku Fier, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur **në** përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara ***jo materiale dhe jo të përhapura***, për të cilën japim ***opinionin të pakualifikuar***.

¹ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

II. Nga auditimi mbi përputhshmërinë: Janë konstatuar parregullsi në zbatimin dispozitave dhe devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

a. -DRISHMPUT Fier ushtron aktivitetin në 6 bashkitë Fier, Patos, Mallakastër, Lushnje dhe Divjakë, për periudhën objekt auditimi, ka kryer 2435 inspektime kundrejt 2903 të parashikuara nga planet mujore ose 83,8%. Ato përfaqësojnë: 1306 inspektime në mjedis kundrejt 1415 inspektime të planifikuara ose 92,3% dhe 1129 inspektime në pyje e kullota kundrejt 1488 inspektime ose 76%, referuar planeve mujore të raportuara.

b. Nga DR ISHMPUT Fier nuk është hartuar e miratuar plani vjetor i inspektimeve në fillim të çdo viti mbështetur në përcaktimin, argumentimin e zgjedhjes së subjekteve dhe fushave për inspektim mbi bazën e riskut si dhe regjistrin të riskut, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Inspektimeve, miratuar me Urdhrin nr.13, datë 23.04.2015 “Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë”;

c. Në kryerjen e inspektimeve janë konstatuar mangësi e parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit të inspektimeve, planeve vjetore, parashikimin e riskut, në sistemimin, arkivimin, përmbledhjen e dokumentacionit përbërës, si: Autorizim inspektimi, procesverbal inspektimi, procesverbal kundra vajtje, raport përmbledhës të inspektimit deri në ekzekutimin e gjobave, sekuestrimeve etj,

d. Nga auditimi i kryerjes së inspektimeve rezultuan me mangësi e shkelje 432 praktika inspektimi, kundrejt 2435 inspektime të kryera ose në 17,7% të totalit të inspektimeve, sipas fushave:

- **në mjedis 250 inspektime** ose 19,1.% kundrejt 1306 gjithsej, në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”; me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenet 45-48 si dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”

- **në Pyje kullota 162 inspektime** ose 14% kundrejt 1129 inspektime (duke përfshire dhe 58 praktikatat e autorizimeve për inspektime të pa përfunduara); mangësi në autorizimet e inspektimit, procesverbalin e inspektimit, në plotësimin e procesverbaleve të vlerësimit të dëmit dhe të vendimit përfundimtar të inspektimit, të cilat ishin në kundërshtim me nenin 45, pikat 1,2,3,4 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në mos përmbushje të kërkesave të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12 dhe me Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe VKM nr.396, datë 21.06.2006,

Opinion i auditimit:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DR ISHMPUT Fier nuk u konstatuan devijime materiale, por devijime në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, që janë ***jo materiale dhe jo të përhapura*** për të cilën **japim opinion të pakualifikuar²**.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

(Propozime për ndryshim Udhëzimi dhe Rregulloreje nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)

² Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, (fq.65, kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i pakualifikuar”, Kur audituesi nuk ka raste mospërputhesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar)

Gjetje 1: DRISHMPUT Fier në inspektimet e sektorit të pyjeve për periudhën 2016, 2017 dhe 9 mujorin e I-rë 2018, krahas masave të tjera, ka vendosur në disa raste sekuestrime materiali drusor (lëndë punimi dhe dru zjarri). Për të dy rastet nuk u paraqit asnjë dokument për marrje dorëzimi dhe mbërritjen në destinacionin përfundimtar të materialit drusor tek përfaqësuesi i organit shtetëror, përkundrazi për drutë e zjarrit të sekuestruara pretendohet se janë në komisariat, kurse lënda e punimit është lënë në dorëzim me procesverbal tek kundravajtësi; paraqitur në tabelën emërtuar “*Tabela e Sekuestrimeve të Materialit Drusor te Kapur dhe Administrimi Përfundimtar periudha nga Tetori 2016 - 9/Mujori I-rë 2018*”. Kjo ka ardhur si pasojë e faktit se Udhëzimin i Ministrisë Mjedisit nr.1, datë 04.07.2014 “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit”, në pikën nr. 4.b ku shprehet: “...*(DSHP).. merr masa për magazinimin dhe më pas, shitjen me ankand të mallit/materialit drusor.... të bllokuar / sekuestruar në brendësi të fondit pyjor kombëtar ose jashtë tij..*” dhe në pikën 5/f ku shprehet: “...*Sektorët e Inspektoratit të Policisë Pyjore të Degëve Rajonale të ISHMPU detyrohen ti përcjellin DSHP-ve:... Procesverbalet e sekuestrimit të lëndës drusore të bllokuar e sekuestruar në pyll dhe në rrugë auto...*”. Në të dy këto pika të Udhëzimit të referuar më lartë nuk përcaktohet qartë mënyra ligjore e administrimit, kontrollit dhe destinacionit final të materialit drusor të sekuestruar. Pra nuk përcaktohet qartësisht mënyra e dokumentimit me dokumentacionin përkatës si fletë hyrje, fletëdalje në procesin e marrjes dhe dorëzimit nga ISHMP tek administruesit dhe menaxherët e Pyje-Kullotave (*DGZM dhe së fundi Organet e NJVQV që kryejnë këtë funksion*).
(*Trajtuar në faqe 102-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.-Rekomandimi:-

DRISHMPUT Fier në bashkëpunim me ISHMPUT Tiranë të marrin masat dhe të hartojnë e miratojnë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit një Udhëzim të ri lidhur me Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, NJVQV-ve dhe ministritë e tjera, dhe të shfuqizojnë Udhëzimin nr.1, datë 04.07.2014 “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit” .

Brenda muajit dhjetor 2019

2. Gjetje: Nga auditimi në DRISHMPUT Fier konstatohet se, Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit, nr.1, datë 15.09.2014, “Për Organizimin Funkcionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe rajonal“, miratuar me shkresën nr.1166, datë 16.9.2016 të Kryeinspektorit rezulton që prej 2 vjetësh e pa përditësuar. Po kështu, dhe Rregullorja nr.668, datë 15.10.2015 e cila është përgatitur nga Dega Rajonale Fier, nuk ka marrë miratimin e ISHMPUT Tiranë ndërsa institucioni ka pësuar ndryshime strukturore nga VKM nr.103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”.

Për sa sipër bëhet domosdoshmëri që këto akte duhen përshtatur, por duhet të harmonizohen dhe përshtaten me Manualin e Inspektimit, miratuar me urdhrin nr.13, datë 23.4.2015” Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, situatë kjo në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”, i ndryshuar.

(*Trajtuar në faqe 132-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: DRISHMPUT Fier dhe ISHMPUT Tiranë të marrin masa dhe të hartojnë e miratojnë Rregulloren e re të brendshme të funksionimit, të përshtatur e përditësuar me ndryshimet strukturore sipas VKM nr.103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, si dhe me kërkesat e Manualit të Inspektimit miratuar me urdhrin nr.13, datë 23.4.2015” Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, duke përfshirë edhe

proceset lidhur me instalimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivel njësie të DRISHMPUT dhe në nivel qendror ISHPM Tiranë.

Brenda muajit dhjetor 2019

C. MASA ORGANIZATIVE

1. -Gjetje nga auditimi:

Në DRISHMPUT Fier ka munguar hartimi i PB dhe PBA për *vitin 2016* (që përgatiten në v. 2015) është hartuar buxheti **për vitin 2017**, si dhe *për vitin 2018* nuk është hartuar buxheti PB dhe PBA (që duhej përgatitur në vitin 2017), mungon urdhri dhe grupi i punës, mungojnë, kriteret. Procedurat dhe afatet nuk dokumentohen mbështetur me treguesit bazë të numrit të inspektimeve, këshillimeve, aktiviteteve kulturalo-edukuese me operatorët e biznesit, shoqatat, organizatat, njësitë e vetëqeverisjes vendore, pleqësitë në fushën e mjedisit, pyjeve, ujërave me kostot përkatëse të çdo inspektimi dhe aktiviteti për vitin 2016, 2017 dhe 2018, *ekzistenca e të cilave do të përbënte (produktin sipas Programeve nr.5320 dhe 4260) dhe bazën mbi të cilat do të mbështeteshin PB dhe PBA reale, funksionale në përmbushje të funksioneve ligjore të DR ISHMPUT Fier; mangësi kjo në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; UMF nr.8, datë 29.3.2012”, ligjin nr.130/2016 “Për Buxhetin e Vitit 2017”, ligjin nr. 109/2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenin 7 dhe neni 16 “Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror” pika 2, gjerat “b” dhe “c”, nenin 12, pika 1 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 “Parimi i këshillimit dhe informimit” dhe të kapitulli IV, pika 256 e UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, si dhe me kapitullin II, paragrafët 2,3 të Manualit të Inspektimeve miratuar me Urdhrin nr.13, datë 23.04.2015”Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, sipas tabelës “Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën 2016, 2017 dhe 9/mujorin 2018 në DR ISHMPUT Fier”.(Trajtuar hollësisht në 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.-Rekomandimi:

DR ISHMPUT Fier, Kryeinspektori, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve në bashkëpunim me ISHMP Tiranë, të hartojnë Projekt buxhetin PB dhe PBA, duke zbatuar procedurat ligjore në kohë, mbështetur në Planveprimet dhe dokumentet e hartuara me parë, në parashikimin e numrit dhe të kostove të produktit “*Misione inspektimi, këshillime, aktiviteteve edukuese me operatorët e biznesit, shoqatat, organizatat, njësitë vetëqeverisjes vendore, pleqësitë, me kostot përkatëse të çdo inspektimi*”, etj., pra në tregues të matshëm, me synim përgatitjen e buxheteve të argumentuara dhe funksional për realizimin e funksioneve, misionit, objektivave, qëllimit dhe planveprimeve përkatës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. -Gjetje nga auditimi:

DR ISHMPUT Fier në zbatimin ndjekjen menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit sipas viteve ka parashikime me rezerva, buxhete të pa argumentuar jo funksional dhe nivele të ulëta realizimi përkatësisht: në vitin 2016 realizuar 92%, ose buxheti është realizuar 16,449 mijë lekë kundrejt planit 17,880 mijë lekë, me mosrealizimi -1,431mijë lekë; në zërin paga e sigurime shoqërore e shëndetësore nga parashikimi mbi nevojat; në vitin 2017 realizuar 90%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar 20,560 mijë lekë kundrejt planit 22,800 mijë lekë, me mosrealizim -2,339 mijë lekë dhe në 9/Mujorin e I-rë 2018 realizuar 83%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar 12,860 mijë lekë kundrejt planit 15,444 mijë lekë, me

mosrealizim -2,583 mijë lekë; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në mos respektim të kriterëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, ligjin nr.147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, ligjin nr. 130/2016 “Për Buxhetin e Vitit 2017”, ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, dhe të Kapitulli IV pika 256 e UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”; pasqyruar në tabelën “Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën 2016, 2017 dhe 9/mujori 2018 të DR ISHMPUT Fier” .(*Trajtuar hollësisht në faqet 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1.-Rekomandimi:DR ISHMPUT Fier, Kryeinspektori strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa të vazhdueshme për menaxhimin dhe ndjekjen e treguesve ekonomik dhe financiar të zbatimit të buxhetit periodik e vjetor dhe në situata mosrealizimi apo pamjaftueshmërie të marrin masa në kohën e duhur për ndryshimet përkatëse, me synim shmangien e mospërdorimit apo të pamjaftueshmërisë dhe të pasojës në mos përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. -Gjetje nga auditimi:

DR ISHMPUT Fier, Njësia e Financës, për periudhën datë 01.10.2016 deri në 30.09.2018 nga mosparashikimi e mos përfshirja në zërin “Shpenzime të tjera transporti, udhëtim e dieta” për punonjësit llog. 602.39 pra në PB dhe PBA e viteve 2016, 2017 dhe 2018, nuk janë llogaritur e shpërblyer 9 punonjës minimalisht në **shumën 125.000 lekë**, për shërbimet e kryera, si dhe nuk janë llogaritur shpenzime udhëtimi për distancat mbi 100 km dhe për shërbimet që zgjatin mbi 3 ditë, në kundërshtim me VKM nr.329, datë 20.04.2016 kreu III, pika 2, ku shprehet: “Për shërbimet në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tyre përfshin dietën ditore në masën 500 lekë..” dhe sipas VKM nr.148, datë 26/02/1998 “Për tarifën e transportit të udhëtareve” në kundërshtim me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, pasqyruar në tabelën emërtuar “Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbimet të plotësuara sipas VKM nr. 329, datë 20.04.2016 hyre ne fuqi datë 20.05.2016 për periudhën 01.10.2016 deri 30.09.2018”.(*Trajtuar në faqe 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

3.-Rekomandimi: Njësia e Financës e DRISHMPUT Fier, të marrë masa dhe të përfshijë në artikullin 602, zërin “Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit” dhe të llogaritin e shpërblejnë për periudhën datë 01.10.2016 deri datë 30.09.2018 për 9 punonjës shumën 125.000 lekë, për shërbimet e kryera sipas autorizimeve dhe të pa likuiduara pasqyruar në tabelën emërtuar “Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbime të plotësuara sipas VKM nr.329, datë 20.04.2016 hyrë në fuqi datë 20.05.2016 për periudhën 01.10.2016 deri 30.09.2018”.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi: Në DRISHMPUT Fier, referuar sistemit të evidencave të realizimit të numrit të inspektimeve të përgatitur nga sektori i Mjedisit dhe i Pyjeve, konstatohet se treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të krahasuar me treguesit e parashikuar në planet vjetore (të cilat mungojnë) dhe nuk janë marrë për bazë as në hartimin e projekt buxheteve përkatëse. Për sa sipër, kjo formë raportimi ka krijuar dobësi në komponentin e COSO-s mbi monitorimi, dhe këto aspekte nuk janë në përputhje me normat e programimit dhe me kërkesat e dispozitave dhe kuadrit ligjor si legjisllacioni “Për MFK“, “Për Buxhetin”, ligjit “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor” dhe udhëzimet përkatëse, dhe me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, nenin 7 dhe neni 16 ”Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror” pika 2 geramat “b” dhe “c” dhe me

VKM nr.103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën “Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për vitin 2016, 2017 dhe 9-Mujori 2018 DRISHMPU Fier”, bashkëlidhur (Trajtuar në faqe 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.-Rekomandimi:- DRISHMPUT Fier, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, njësia e financës dhe përgjegjësit e sektorëve të marrin masa në të ardhmen, që në ndjekjen dhe raportimin e treguesve ekonomik, të raportohen jo vetëm me në nivelin faktik por të krahasuar dhe me nivelin e parashikuar, programuar, në pasqyrimin dhe raportimin në relacionet, raportet dhe tabelat e treguesve të nivelit të realizimit të numrit të inspektimeve, duke i tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në planet vjetore (të cilat mungojnë) dhe në projekt buxhetet përkatëse, formë kjo raportimi në përputhje me normat e programimit dhe kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

5.Gjetje: DRISHMPUT nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar në kundërshtim me Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë”. Sektori i Inspektimit mjedisit nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas subjekteve në ekonomitë pyjore të cilat operojnë në Qarkun Fier. Veprime këto në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.4, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut". Nuk disponohen kopjet e hartave të ekonomive pyjore, planet e mbarështimit dhe të inventarizimit, hartat e zonave të mbrojtura, ndarjet e pronësisë së fondit pyjor e kullësor, planet e menaxhimit të pyjeve komunale dhe private (Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5.1: DR ISHMPUT Fier të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në ekonomitë pyjore, si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt objekt inspektimi për sektorin e mjedisit dhe në sektorin e pyjeve, të sigurojë dokumentacionin tekniko-ligjor për këto subjekte duke përfshirë dhe planet e mbarështimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale dhe private.

Menjëherë

6.Gjetje: Sektori i Inspektimit mjedisor në DR ISHMPU Fier nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Fierit. Nuk është bërë identifikimi i subjekteve dhe rankimi e prioritizimi i atyre që ekspozohen me risk të lartë e ndikim në mjedis, mbështetur në të dhëna të adminstruara në regjistra ose në data-base të veçanta. Kjo është kërkesë në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhri i Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe nr.4, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".

DR ISHMPU në planifikimet vjetore e mujore dhe në inspektimet e kryera, nuk ka përfshirë një masë të konsiderueshme të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Fierit, të publikuara nga bashkia Fier si aktivitete me ndikim në mjedis, në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” (Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: DR ISHMPUT Fier nëpërmjet sektorit të mjedisit të marrë masa që programet vjetore dhe mujore të inspektimit të hartohen në bazë rrisht, ku të përcaktohet në

detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Qarku e Fierit dhe përqendrimi në ato aktivitete që kanë mundësi ndikimi negativ në mjedis, duke parashikuar një gamë më të gjerë subjektësh për kryerjen e inspektimeve, jo vetëm ato të raportuara me leje mjedisore nga DRM Fier, por në bashkëpunim me institucionet e tjera si; Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Qarkut Fier, QKB Bashkitë në Qarkun Fier dhe institucione të tjera.

Vazhdimisht

7. -Gjetje nga auditimi:

Në 48 raste në procesverbalet e hartuara nga inspektorët në proceset e inspektimit u evidentuan parregullsi dhe mosplotësim të kushteve të lejeve, pasi nuk përcaktohen se cilat kushte nuk janë realizuar sipas emërimit të pikave të lejes. Në inspektimet e kryera, (si ato fillestare dhe ato verifikuese), inspektorët janë kontradiktorë në konstatimet e tyre në përcaktimin e llojit të aktivitetit. Gjithashtu, në shumë raste është lënë si detyrë plotësimi i kushteve të lejes ose rishikim i kushteve të lejes, pa përcaktuar specifikisht se për çfarë kushtesh bëhet fjalë. Ka raste kur subjektit i është lënë detyrë të plotësohet “dokumentacioni mjedisor” mirëpo nuk përcaktohet se cilat dokumente mungojnë. Në disa raste është kërkuar në formë të përgjithshme plotësimi i kushteve të lejes, pa u shprehur në gjithë përshkrimin e procesverbalit të inspektimit, nëse janë shkelur ndonjë kusht i lejes dhe pa përcaktuar se cilat janë ato. Gjithashtu, në këto dokumente konfirmohet vetëm që subjekti ka plotësuar raportin e monitorimit periodik, ndërsa në ri-inspektim inspektorët shprehen vetëm për plotësimin e vetmonitorimit dhe jo për kushtet e lëna si detyrë në inspektimin paraardhës. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit” dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 (*Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandim:Sektori i mjedisit në DR ISHMPUT Fier të marrë masa, që në procesin e inspektimit përshkrimi konstatimeve në procesverbalet e inspektimit të bëhet në mënyrë të saktë e të detajuar, pasi të jenë verifikuar në mënyrë të plotë informacionet e marra nga subjekti në formë dokumentare dhe verifikimi në terren i veprimtarisë në drejtim të zbatimit të kushteve të lejes, si dhe të bëhet referimi i saktë dhe i plotë i dispozitës ligjore për moszbatimin apo jo të lejes së mjedisit dhe në rastet e mosplotësimit të kushteve të përcaktuara të shprehen qartë për detyrat e lëna në mënyrë që në momentin e ri-inspektimit të jenë lehtësisht të verifikueshme për zbatim.

Vazhdimisht

8. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se grupet e inspektimit në terren nuk janë shprehur në lidhje me kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit dhe të dhënat tjera që kanë të bëjnë me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë, si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren. Rezulton se është kryer vetëm një verifikim i thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore të tarifave mjedisore, si dhe të paraqitjes thjesht të dokumentit të vetë monitorimit, pa vërtetuar nëse treguesit e saj janë real apo jo në aspektin e përgjithshëm. Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 65 të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit

nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”(Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Sektori i inspektimit të mjedisit në DR ISHMPU Fier, në procedurat e kryerjes së inspektimeve, krahas kontrollit të zbatimit të kushteve të lejeve dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të mjedisit, duhet të përqendrohet edhe në verifikimin në terren të normave cilësisë së mjedisit për ndotës, apo grupe të veçanta ndotësish krahasuar me rezultatet e vetmonitorimit për të siguruar përputhshmërinë me kushtet e lejes dhe legjislacionin përkatës.

Vazhdimisht

9. -Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se 20 subjekte janë të pa pajisura me leje mjedisore. Nga DR ISHMPU Fier nuk është realizuar inspektimi i verifikimit të realizi mit të detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Gjithashtu, për këto subjekte nuk është marrë vendim administrativ “Dënim me gjobë” për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenet 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet” (Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa për të programuar 20 subjektet të listuara në tabelën e paraqitur në faqen 17-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nëse vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre, të merrem masa administrative dënim me gjobë për shkeljet ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. -Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të realizimit të inspektimit të vënë në dispozicion rezultoi se, subjektet nuk kanë plotësuar kushtet e lejeve të lëna detyrë, nuk kanë paraqitur raportet e vetmonitorimit periodik (6-mujor) pranë grupit të ri-inspektimit, si dhe ka raste të mosparaqitjes së pagesës së tarifës vjetore për lejet mjedisore. Për këto raste nuk është ndjekur një procedurë e plotë për detyrimin e realizimit nga subjektet të këtyre kushteve, ose në të kundërt vendosja e masave administrative “dënim me gjobë”.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenet 45-48, me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”, pika 5, neni 17”Afatet e shqyrtimit” (Trajtuar në faqen 17-34 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa për të programuar dhe ri-inspektuar subjektet, në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna në drejtim të zbatimit të kushteve të lejeve, detyrimeve financiare dhe të rishikimit të kushteve të lejeve. Në rast konstatimesh të mosplotësimit të këtyre kriterëve mjedisore të merren masa administrative për kundravajtje në fushën e mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje: DR ISHMPUT Fier, sektori i Inspektimeve në Mjedis nuk e ka mbështetur planin e inspektimeve në informacione të plota mbi numrin e subjekteve që operojnë në zona të ndryshme dhe në total. Për rrjedhojë nuk ka të dhëna mbi subjektet që janë mbuluar me inspektim. Mbi këtë bazë duhet të bëhej ndarja e subjekteve për çdo inspektor, duke e përcaktuar dhe vlerësuar llojet e inspektimit në vartësi me kapacitetin ekonomik, përcaktuar në ligjin nr.10431, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”. Mungesa e një klasifikimi të tillë bën që planifikimi të bëhet pa llogaritur risk, duke përcaktuar subjektet me kapacitet ekonomik të madh, bërë një shpërndarje racionale të punës për çdo grup inspektorësh ose si

individ për të siguruar një efektivitet të lartë inspektimi (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: DR ISHMPUT Fier, sektori i Inspektimeve në Mjedis të marrë masa që plani i inspektimeve ta mbështetet në informacione të plota mbi numrin e subjekteve që operojnë në zonat të ndryshme. Për këtë të bashkëpunojë me instucionet e qarkut si: Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Qarkut Fier, QKB, Bashki e Njësi Administrative dhe institucione të tjera që janë objekte të ndotjes dhe mbetjeve integrale. Mbi këtë bazë, të bëjë ndarjen e subjekteve për çdo inspektor duke përcaktuar dhe vlerësuar llojet e inspektimit mbështetur në kapacitetin ekonomik Klasifikimi dhe planifikimi të bëhen duke llogaritur riskun dhe përcaktuar subjektet me kapacitet ekonomik të madh, me një shpërndarje racionale të punës për çdo grup inspektorësh ose si individ për të rritur efektivitetin e inspektimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

12. Gjetje: DR ISHMPUT Fier, sektori i Mjedisit nuk ka planifikim të drejtë të kohës optimale për kryerjen e një inspektimi. Në autorizimet e dhëna përcaktohet verifikimi konkret i dokumentacionit dhe bazës ligjore që mund të përbëje shkelje vetëm i një kushti pa lënë hapësirë që inspektori të ketë mundësi të konstatojë, verifikojë dhe evidentojë çdo kusht tjetër të lejes së mjedisit apo trajtimi të mbetjeve. Inspektimi spontan dhe pa llogaritur saktë kohën e kryerjes nuk jep konkluzione mbi ngarkesën dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: DR ISHMPUT Fier, sektori i Mjedisit të marrë masa që në programet e inspektimit të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak dhe njohja profesionalisht e mundësisë së ndikimeve në mjedis duke cilësuar në autorizim të drejtën inspektorit për mundësi të konstatimeve, verifikimeve dhe evidentimeve të mangësive, apo shkeljeve për çdo kusht tjetër të lejes së mjedisit apo trajtimi i mbetjeve të cilat duhet të paraqiten në analizat e raportit teknik.

Menjëherë dhe vazhdimisht

13.Gjetje: Nga auditimi me zgjedhje i 50 praktikave të inspektimeve të kryera, konstatohet se në procesverbale nuk ka të dhëna mbi evidentimin e shkeljes së kryer dhe referencës ligjore përkatëse. Gjithashtu, në vendimin e inspektorit nuk ka argumente për shkallën e ndëshkimit administrativ, bazuar në dëmin e shkaktuar e të llogaritur në mjedis, zgjatjen në kohë të efektit të dëmit, në se rasti shkeljes është përsëritur ose jo(*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandimi : DR ISHMPUT Fier, sektori i inspektorëve të mjedisit të marrin masa dhe të pasqyrojnë hollësisht në procesverbalet e konstatimit dhe në formulimin e vendimeve, llojin e shkeljes dhe referencën ligjore, dëmin ekonomik dhe arsye të tjera bindëse për masën ndëshkuese të kundërvajtjes administrative.

Vazhdimisht

14.Gjetje: Grupet e inspektimit në terren nuk kanë marrë mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, pajisjeve, informacione për proceset apo makineritë dhe t'ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave, në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tij, nëse është e nevojshme të bëhen nga subjektet e akredituara, në kundërshtim me nenit 38 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1- Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyetjeve, si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera. Të krijojnë dosje

inspektimi, duke plotësuar praktikat me materiale argumentuese nëse është e nevojshme si: mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, pajisjeve, informacione për proceset apo makineritë dhe t'ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave, në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tyre nga subjektet e akredituara.

Menjëherë dhe vazhdimisht

15.Gjetje: Grupet e inspektimit në terren, nuk kanë kërkuar dhe marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit dhe nuk ka asnjë rast sekuestrimi të dokumenteve që lidhen me objektin e inspektimit, si dhe dokumente të ruajtura në trajtë elektronike, regjistrime elektronike e audio-vizive apo të çdo lloj teknologjie tjetër me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit, në moszbatim të nenit 39 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1.Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të instruktojë e të trajtojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera. Të krijohen dosje inspektimi duke plotësuar praktikat me materiale argumentuese si: kopje të dokumenteve të veprimtarisë në përputhje me objektin e inspektimit, sekuestrime të dokumenteve që lidhen me objektin e inspektimit, si dhe dokumente të ruajtura në trajtë elektronike, regjistrime elektronike e audio-vizive apo të çdo lloj teknologjie tjetër me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit.

Vazhdimisht

16.Gjetje: Grupet e inspektimit në terren nuk kanë kryer fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjedisve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjedisve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit, në moszbatim të germës “a”, neni 41 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë ” (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të instruktojë e të trajtojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke plotësuar praktikat me materiale argumentuese.

Vazhdimisht

17. Gjetje: Grupet e inspektimit në terren kanë mbajtur proces-verbalet e inspektimit, të cilat nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe nuk janë shoqëruar me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit, në moszbatim të nenit 45 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të instruktojë e të trajtojë inspektorët e terrenit për mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke mbajtur proces-verbalet e inspektimit, të cilat të përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe të shoqërohen me listë-verifikimet.

Vazhdimisht

18. Gjetje: Grupet e inspektimit në terren *në 52 raste ku aktivitetet janë konstatuar “të mbyllura”* dhe **11 raste** që nuk është gjetur përfaqësuesi i subjektit, apo nuk kishin lënë afat për zbatimin e detyrave, dhe ri inspektimin, në moszbatim të nenit 65 të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, gjë që le shteg për mos ndjekje të detyrave të lëna dhe në përfundim mos evidentim të rasteve për vendosje gjobash dhe pezullim të aktivitetit (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojnë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe për konstatimet e kryera në inspektimin e parë të ushtruar në subjektet e inspektimit, të lihen detyra për zbatim me afate të përcaktuara duke mos kaluar tavanin e vendosur ligjërisht prej 8 ditësh.

Vazhdimisht

19 Gjetje: Nga auditimi i raportimeve mbi realizimin e inspektimit bazuar në autorizimet e lëshuara nga titullari i institucionit, konstatohet se inspektorët e mjedisit kanë paraqitur formalisht dhe vetëm me element të thjeshtë si një fotografi thjeshtë e vendit, për zbatimin e ligjit të grumbullimit të mbetjeve urbane pa të dhëna dokumentare se cili pronar e disponon këtë territor, statusi ligjor i pronësisë, akti pronësisë dhe harta treguese, marrëdhëniet me subjektet shtetërore për detyrimet fiskale, kapaciteti i parashikuar në raport më kontratat e lidhura nga subjektet (*Trajtuar në faqet 34-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: DR ISHMPUT Fier të marrë masa në vazhdimësi dhe të vendosë në se rastet kur arrihet vlerësimi i cilësuar *“pa autor”* për gjendjen e mbetjeve të integruara të mbeturinave të kërkojë forma bashkëpunimi me institucionet e policisë bashkiake dhe rendit për ndjekjen në rrugë operative të gjendjes së konstatuar.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 20: Në DRISHMPUT Fier ka munguar dhe nuk është hartuar një tabelë grupimi analitik i inspektimeve të kryera në sektorin e pyjeve sipas klasifikimit: Inspektime në Zonat e mbrojtura me pyje mbrojtëse a. në vijën bregdetare, brigjet lumore dhe përrenj me prurje lumore, në zonat e mbrojtura me pyje prodhuese, kullota livadhe, monumentet e natyrës, zona të përziera. Ky klasifikim do të siguronte rritjen e efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara dhe përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, të cilat janë të kufizuara në raport me shtrirjen territoriale të Qarkut Fier me vijë bregdetare të konsiderueshme dhe vijë lumore të disa lumenjve kryesorë. Kjo gjendje është në mos përmbushje të Kreu I, pikat 1.4 dhe 1.5 dhe kapitulli II “Programimi i Veprimtarive të Inspektimit” të Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit, miratuar me Urdhrin nr.13, datë datë 23.4.2015 “Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqe 79-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 20.1: DR ISHMPUT Fier të marrë masa hartojë tabela përkatëse të grupimit analitik të inspektimeve të kryera në sektorin e pyjeve sipas klasifikimit, me synim rritjen e efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara dhe përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, në raport me shtrirjen territoriale të Qarkut Fier në 6 bashki, me vijë të konsiderueshme bregdetare dhe vijë lumore të disa lumenjve kryesor të vendit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 21: DR ISHMPUT Qarku Fier evidenton në juridiksionin e saj një sipërfaqe e strukturë të konsiderueshme fondi pyjor prej 52,050 ha, të shpërndara në 3 Bashkitë Fier, Mallakastër dhe Lushnjë, e cila është e pa përditësuar dhe nuk përfshin fondin e bashkive të reja, Patos, Divjakë dhe Roskovec; strukturë ku predominojnë pyjet mbrojtës bregdetar e lumor, pyjet e Zonave të Mbrojtura kryesisht bregdetare dhe pyje të tjera me funksion çfarëdo e kullota. Kjo gjendje është në mospërmbushje të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën “Struktura e Fondit Pyjor-

Kullosor në Qarkun Fier në Juridiksion të DR ISHMPUT Fier⁴. (Trajtuar në faqe 79-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 21.1: DR ISHMPUT Fier të marrë masa të përditësojë strukturën e fondit pyjor kullosor prej 52050 ha, në juridiksionin duke identifikuar fondin përkatës për secilën prej 6 bashkive Fier, Mallakastër, Patos, Roskovec, Lushnjë dhe Divjakë dhe strukturën sipas formës së qeverisjes, me synim identifikimin e subjekteve publik dhe privat objekte inspektimi, mbështetur në ndryshimet e reformës territoriale dhe krijimit të Bashkive të reja.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 22: DR ISHMPUT Fier nuk ka kryer në bashkinë Roskovec, verifikimin e zbatimit të detyrave për lirim dhe kthimin e sipërfaqes së fondit pyjor prej 1,5 ha të zaptuar e mbjellë me kultura, krahas arkëtimit të vlerës së dëmit prej 3,174,500 lekë dhe vlerës së gjobave prej 700,000 lekë, masa këto vendosur në 7 Vendimet përfundimtare, mosveprime në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përbushje të kërkesave të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, dhe me Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, pasqyruar në tabelën emërtuar “Regjistri i Kundravajtjeve ne Pyje, Kullota e Gjueti nga Tetor 2016 deri ne 9/Mujori I-rë 2018 “. (Trajtuar në faqe 79-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 22.1: DR ISHMPUT Fier të marrë masa për kryerjen e inspektimit në Bashkinë Roskovec, për verifikimin e detyrave lidhur me lirim dhe kthimin e sipërfaqes së fondit pyjor prej 1,5 ha të zaptuar e mbjellë me kultura, krahas arkëtimit të vlerës së dëmit prej 3,174,500 lekë dhe vlerës së gjobave prej 700,000 lekë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 23: DR ISHMPUT Fier nuk ka kryer në bashkinë Lushnje dhe Divjakë, verifikimin e zbatimit të detyrave lidhur me lirim dhe kthimin e sipërfaqes së fondit pyjor prej 0,28 ha të zaptuar e mbjellë me kultura, krahas arkëtimit të vlerës së dëmit prej 700,000 lekë dhe vlerës së gjobave prej 240,000 lekë; përcaktuar në 3 Vendimet përfundimtare, mosveprim në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përbushje të kërkesave të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, dhe me Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, pasqyruar në tabelën emërtuar “Regjistri i Kundravajtjeve ne Pyje, Kullota e Gjueti nga Tetor 2016 deri në 9/Mujori I-rë 2018“ (Trajtuar në faqe 79-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 23.1: DR ISHMPUT Fier të marrë masa për kryerjen e inspektimit në bashkinë Lushnje dhe Divjakë lidhur me verifikimin e detyrave vendosur në 3 Vendimet përfundimtare për arkëtimin e vlerës së dëmit prej 700,000 lekë dhe vlerës së gjobave prej 240,000 lekë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

24. Gjetje: Mbështetur në dokumentet e paraqitura si 58 autorizimet e inspektimi në pyje për sektorin Mallakastër periudha Qershor-Shtator 2018 në mangësitë e mospërputhjet në hartimin e 18 procesverbaleve përkatës dhe për 40 procesverbale të sjella me vonesë dhe të pa arkivuara, për të cilat vlerësojmë se nuk janë përbushur detyrat ligjore dhe funksionale në lidhje me autorizimet e lëshuara për inspektim, të cilave u mungonte dokumentacioni përkatës mbi veprimet e kryera nga inspektorët dhe paraqitja Kryeinspektorit. Kjo ka sjellë si pasojë mosadministrim të procesit të inspektimit, duke cenuar funksionet kryesore të DR ISHMPUT Fier. (Trajtuar në faqet 100-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 24:DR ISHMPUT Fier për cdo autorizim inspektimi të lëshuar të hapë dosje përkatëse duke i bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, të hartuar dhe dokumentuar sipas hapave e procedurave ligjore të kryerjes së inspektimit, gjithashtu me lëshimin e cdo

autorizim inspektimi të ndiqet ecuria e procesit dhe dokumentimit ligjor deri në mbylljen dhe inventarizimin e dosjes së IT.

Vazhdimisht

Gjetje 25: Sektori i Policisë Pyjore i DRISHMPUT Fier ka filluar me vonesë kryerjen e inspektimeve me programin online dhe nga data 13.04.2018 deri me datën 30.09.2018, janë kryer vetëm **5 inspektime online**; ndërsa deri 3.01.2019 janë 22 inspektime, vetëm ne subjekte që kanë nr Nipt-i identifikuar si Bashki, persona fizik të kapur në flagrancë. Në këtë periudhe nuk janë mundur inspektimet me sistemin online ose vetëm 5, ne ekonomitë pyjore, kullosore, zona te mbrojtura dhe ne gjueti.

Arsyet numrit të kufizuar të inspektimeve me metodën on-line ne ekonomitë pyjore, kullosore, zona te mbrojtura dhe ne gjueti lidhen me nevojën e përsosjes, përfshirjen dhe modifikimin për zgjidhjen e problemeve si më poshtë:

1-Mungon identifikimi i futjes ne sistem për përcaktimin e ekonomive pyjore, kullosore, zonave te mbrojtura dhe i ngastrave, për te cilat do te kryhet inspektimi. Kjo mangësi lidhet me mos pajisjen apo hedhjen ende ne sistemin e inspektimit online.

2-Mungon formati i procesverbalit për inspektimin online, ne ekonomitë pyjore, kullosore dhe për zonat e mbrojtura.

3- Mungon formati i procesverbalit për inspektimin online, për gjueti te pa ligjshme.

4-Mungon formati i procesverbalit për vlerësimin e demit.

5- Mungon formati i procesverbalit për kallëzimin penal.

6- Mungon formati i procesverbalit të sekuestrimeve.

7-Problemi i identifikimit te kundravajtesit ne kushtet e flagrancës, kur nuk kanë apo kur nuk te paraqesin kartën ID (ne ekonomit pyjore, kullosore, ne rruge auto etj).

8-Problemi i planeve mujore apo vjetore te punës sipas ekonomive pyjore, kullosore,zonave te mbrojtura,gjueti etj, pasi sistemi i inspektimit online pranon vetëm subjekte me nr. Nipti ,gjë e cila në ekonomit pyjore, kullosore nuk ekziston(*Trajtuar në faqe 102-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 25.1: DR ISHMPUT Fier dhe ISHMPUT Tiranë të marrin masa për përsosjen, përfshirjen dhe modifikimin në programin e inspektimeve on-line të lidhura për zgjidhjen e një sërë problemesh cituar më sipër, me synim *rritjen e numrit të inspektimeve* kryerjen e inspektimeve *në zonat me rrisk*, si në ekonomitë pyjore, kullosore, zona të mbrojtura dhe në gjueti.

Menjëherë

Gjetje 26: DR ISHMPUT Fier, në periudhën 3/Mujori IV-rë 2016 deri 31.12.2018, nuk ka parashikuar, planifikuar e nuk ka kryer asnjë dokumentim inspektimi me tematikë zonale apo me objekt individualisht të caktuar për inspektimin e **31 monumenteve të natyrës shqiptare**, si një resurs i madh me funksion nxitës për turizmin në juridiksionin e Qarkut Fier shpërndarë përkatësisht: *Fier 5 objekte, Lushnje 15 objekte, Mallakastër 11 objekte*; shpallur me VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare", dhe gjithashtu për Njësitë administruese ka qenë detyrë ndarja dhe evidentimi i tyre sipas përkatësisë së vendndodhjes sipas ekonomive pyjore e ngastrave. Përfshirja e tyre në planet e menaxhimit, mbarështimit në planin e shpenzimeve ashtu vendosjes e administrimit të të ardhurave prej vizitorëve turistik, por dhe detyra për propozimin e përfshirjen në zgjerimin e listës edhe me objekte te tjera për vënien në mbrojtje dhe evidentimin e nxjerrjen në pah të vlerave turistike të tyre. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", neni 38, 40 dhe neni 40/2 dhe me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe UMF nr.30, datë

29.12.2011”Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik”(Trajtuar në faqe 102-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 26.1: DRISHMPUT Fier, të marrë masa të parashikojë, planifikojë në planet vjetore e periodike të inspektimeve, të kryejë e dokumentojë inspektime tematike zonale apo me objekt individualisht të caktuar të **31 monumenteve** të natyrës shqiptare si resurs i madh me funksion nxitës për turizmin e Qarkut Fier, si dhe të përfshijë në inspektime edhe detyrimet për Njësitë administruese evidentimin sipas përkatësisë së vendndodhjes sipas ekonomive pyjore, ngastrave si dhe përfshirjen e tyre në planet e menaxhimit mbarështimit si në planin e shpenzimeve ashtu dhe të vendosjes e administrimit të të ardhurave prej vizitorëve turistik, si dhe të procedurave për propozimin, përfshirjen në zgjerim të listës me objekte të tjera vënien në mbrojtje, evidentimin e nxjerrjen në pah të vlerave turistike të tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se DR ISHMPUT Fier mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrja e bilancit dhe pasqyrave financiare nuk mbahet në mënyrë elektronike dhe sipas një programi financiar i lidhur me qendrën (Ministrinë e Mjedisit) on-line. (Trajtuar në faqet 121-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi. Drejtoria dhe sektori i financës e kontabilitetit i DR ISHMPUT Fier të marrë masa dhe të kërkojë pranë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit akordimin e fondit për mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e bilancit dhe pasqyrave financiare, me qëllim që të mbahet në mënyrë elektronike dhe sipas një programi financiar i lidhur me qendrën on-line.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se **16 subjekte janë në proces** për tu pajisur me leje mjedisore. DR ISHMPU Fier ka ushtruar inspektime për verifikimin e detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Në këto subjekte, ka rezultuar se kanë filluar procedurat e licencimit mjedisor, por nuk është proceduar për rishikim në periudha të mëvonshme nëse këto subjekte janë pajisur përfundimisht me leje mjedisore. Mungesa e ri-inspektimeve ka sjellë mosverifikimin deri në pajisjen me leje mjedisore të subjekteve në proces licencimi dhe mosevidentimin e rasteve të refuzimeve, të cilat përbëjnë objekt dënimi me gjobë për kundravajtje në shumën nga 300,000 lekë-500,000 lekë, e llogaritur për **16 rastet** me masën minimale të gjobës rezulton vlerën prej **4,800,000 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenet 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”. Nuk ka njoftim të DR ISHMPU Fier nga këto subjekte apo nga DRM Fier për marrjen apo jo të lejeve të mjedisit (Trajtuar në faqen 13-30 të Projekt Raportit të Auditimit).

28.1.Rekomandim: DR ISHMPU Fier të marrë masa dhe të hartojë plane inspektimi për **16 subjektet**, nëpërmjet ri-inspektimit që të paraqesin dokumentacionin ligjor për finalizimin e procesit të licencimit me leje mjedisi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. TË ARDHURA TE MUNGUARA

1.Gjetje: Për periudhën tetor 2016-30 tetor 2018, janë marrë vendime administrative “gjobë” në 49 raste në vlerën **17.640 mije lekë**, të ndara për sektorin e Inspektimit të Mjedisit 23 gjoba në vlerën 10,450 mijë lekë dhe për sektorin e Inspektimit të Pyjeve janë 26 gjoba në vlerën 7,190 mijë lekë. Nga këto nga ISHMPUT Fier 9 gjoba në vlerën **prej 980 mije lekë**, janë përcjellë me shkresa në Gjykatën Administrative për kthim në titull ekzekutiv, Gjoba ne ankimim gjyqësor në proces 2, gjoba ne pritje te ankimimit gjyqësore 5, gjobat te shfuqizuara si dhe gjoba në zyrën e përmbarrimit 26, si dhe një gjobë e shlyer vullnetarisht. *(Trajtuar në faqen 109-116 të Projekt Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Kryeinspektori DR ISHMPU Fier nëpërmjet Sektorëve të Inspektimit dhe Juristit, të marrë masa për arketimin e gjobave në 49 raste në vlerën **17.640 mije lekë** dhe të përcjellë vazhdimisht shkresa administrative gjykatës për urdhra ekzekutiv, për 9 gjobat të cilat ndodhen pranë gjykatës si dhe të ndjekë në vazhdimësi e të rritë praninë në proceset gjyqësore me qëllim ndjekjen deri në fund të zbatimit të akteve administrative, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me gjoba për vjeljen sa më shpejt të tyre. Gjithashtu pavarësisht kontratave të përmbarrueseve të lidhura me Inspektoratin Qendrorë duhet kërkuar here pas here informacion për ecurinë e gjobave të vjela nga zyrat përmbarrimore dhe ne rastin konkret 26 gjoba.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. MASA DISIPLINORE

-Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010“Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, i ndryshuar, **i rekomandoj Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:**

a. “Largim nga shërbimi civil”, për 4 punonjësit e sektorit mjedisit, si më poshtë:

1- Për z. A. C me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr.9- 10 datë 17.01.2019 “Inspektimi në fushën e mjedisit”, ku konstatohet se; Sipas autorizimit të inspektimit nr.762, 1, prot, datë 22.08.2017, nr.737, 1 prot, datë 09.08.2017, nr.810, 1 prot, datë 14.08.2017, nr.812/2 prot, datë 14.08.2017, nr.1023/1 prot, datë 05.10.2017, nr. 1030/1 prot, datë 09.10.2017, nr.1040 prot, datë 11.10.2017, nr.1045 prot, datë 12.10.2017, autorizimit on-line të inspektimit nr.000052-1 prot, datë 23.04.2018, autorizimit on-line të inspektimit nr.000067-1 prot, datë 04.07.2018, etj. lidhur me kërkesën që “Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përyjashtimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara

shprehimisht me ligj. dhe nenit 24” Inspektimi i programuar’ pika 1,2,3. -Subjekti nuk ka njoftim, veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit.

-Nga procesverbali i mbajtura, mbi inspektimin e kryer është konstatuar se subjekti i lartpërmendur nuk është pajisur me leje mjedisi të tipit C.

-Nga grupi i inspektimit nuk evidentohet në se ka patur inspektim të mëparshëm dhe sa kohë ka që subjekti ushtron aktivitetin.

-Në autorizim nuk shpjegohen shkaqet të tjera që diktojnë kryerjen e inspektimit.

- Nuk ka bashkëpunim në zbatim të neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë ...” ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për veprimtarinë dhe rezultatet e saj për bashkëpunimin me institucione të tjera si NJVQV, DRTT Fier për statusin financiar të subjektit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nga inspektimi cilësohet se subjektet nuk ka kontratë me firmën e licencuar për transportimin e mbetjeve spitalore si dhe kur kanë nuk është evidentuar dokumentacioni i lëvizjes së mbetjeve si dhe shlyerja e detyrimeve financiare për këtë qëllim.

-Nga inspektori nuk ka shënime në procesverbal dhe në dokumente të tjera për përkrahje të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, nenit 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”.

-Nga auditimi për zbatimin e pikës 3, 4 të nenit 45 të ligjit, për përmbajtjen e procesverbalit konstatohet se procesverbalet nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit si dhe nuk shoqërohen me listë-verifikimin e provave gjatë inspektimit. Procesverbalet i inspektimit nuk përmbajnë informacion për të drejtën e subjektit të inspektuar në rast se ka që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Gjithashtu në asnjë rast nuk ka procesverbale ku të shënohen marrja e dokumenteve, fotokopje e lejeve mjedisore të lëshuara nga DRM, dhe prova të tjerë që legjitimojnë inspektimin dhe që konkretisht janë përcaktuar qartë nga ligji.

-Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se inspektori në terren nuk është shprehur në lidhje me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren, Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 65, të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, nenit 14 “Vlerat kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

2- Për z. F.B., me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për mangësitë dhe shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr.9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi në fushën e mjedisit”, ku rezultojnë në disa raste :

-Nuk është bërë njoftim paraprak të subjektit për inspektimin e kryer në zbatim të autorizimit nr. 675, 675/a prot. datë 19.07.2017, nr.799/1 datë 10.08.2018, nr 803 datë 15.07.2018, nr nr.843 prot, datë 17.08.2017 .

Nga auditimi konstatohet se -Subjekti nuk ka njoftim, veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit nr.10433 datë 16.06.2011.

- Inspektori është shprehur në procesverbal se ka konstatuar se subjekti ka zbatuar detyrën e lënë nga inspektimi i mëparshëm por pa cituar konkretisht llojin e detyrës. **Në procesverbal nuk ka të dhëna për zbatimin e nenit 48 Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit** pika 5, në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni dhe pikës 6. Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjohë, në vlerë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.

Në procesverbal nuk ka përshkrime të detajuara sipas kërkesës së formatit tip të tij me aneksin 4.

Në zbatim të autorizimit të inspektimit nr.745/1 prot, datë 01.08.2017, nr.762/1 prot, datë 07.08.2017 në autorizim nuk është shënuar data e kryerjes dhe afati i kohëzgjatjes së inspektimit.

Nga procesverbalet e mbajtur me nr. Serie mbi inspektimin e kryer është konstatuar se objekti i lartpërmendur gjeneron mbetje spitalore me sasi të përcaktuar për cdo muaj dhe ka lidhur kontratë me firmën Me-di tel të vlefshme deri me 31.12.2017 por subjekteve nuk i janë lënë detyra të tjera për zbatim si mbajtjen e regjistrit të mbetjeve dhe nuk është dhënë gjohë.

-Sipas autorizimit të inspektimit nr.773/3 prot., datë 08.08.2017, inspektori nuk ka shënime në procesverbal rreth marrëdhënieve kontraktuale me firmën për vendin e largimit të mbeturinave, apo për përshkrime të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, neni 41”të drejta të tjera të inspektorit

-Subjekteve nuk i është kërkuar leja mjedisore dhe fotokopja ti bashkangjitej praktikës si provë e inspektimit si dhe të konfirmohet elektronikisht në QHKL dhe ISHMPU për pajisjen me Leje medisore.

-Nga auditimi për zbatimin e pikës 3, 4, të nenit 45 të ligjit, për përmbajtjen e procesverbalit konstatohet se procesverbalet nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit si dhe nuk shoqërohen me listë-verifikimin e provave gjatë inspektimit. Procesverbalet i inspektimit nuk përmbajnë informacion për të drejtën e subjektit të inspektuar në rast se ka që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Gjithashtu në asnjë rast nuk ka procesverbale ku të shënohen marrja e dokumenteve, fotokopje e lejeve mjedisore të lëshuara nga DRM, dhe prova të tjerë që legjitimojnë vertësinë e inspektimit dhe që konkretisht janë përcaktuar qartë nga ligji.

Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se inspektori në terren nuk është shprehur në lidhje me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren , Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44“Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

3- Për znj. A. N., me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushën e mjedisit”.

Ku konstatohet se ;

Sipas autorizimit të inspektimit *nr.762, 1, prot,* datë 22.08.2017, *nr.737, 1 prot,* datë 09.08.2017, *nr.810, 1 prot,* datë 14.08.2017 , *nr.812/2 prot,* datë 14.08.2017, *nr.1023/1 prot,* datë 05.10.2017, *nr.1030/1 prot,* datë 09.10.2017, *nr.1040 prot,* datë 11.10.2017, *nr.1045 prot,* datë 12.10.2017, autorizimit on-line të inspektimit *nr.000052-1 prot,* datë 23.04.2018, autorizimit on-line të inspektimit *nr.000067-1 prot,* datë 04.07.2018, etj.

lidhur me kërkesën që “Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përjashtimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj. dhe nenit 24” *Inspektimi i programuar’ pika 1,2,3. - Subjekti nuk ka njoftim, veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit.*

-Nga procesverbali i mbajtura, mbi inspektimin e kryer është konstatuar se subjekti i lartpërmendur nuk është paisur me leje mjedisi të tipit C.

-Nga grupi i inspektimit nuk evidentohet në se ka patur inspektim të mëparshëm dhe sa kohë ka që subjekti ushtron aktivitetin.

-Në autorizim nuk shpjegohen shkaqet të tjera që diktojnë kryerjen e inspektimit.

- Nuk ka bashkëpunim në zbatim të neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë ...” ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për veprimtarinë dhe rezultatet e saj për bashkëpunimin me institucione të tjera si NJQV, DRTT Fier për statusin financiar të subjektit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nga inspektimi cilësohet se subjektet nuk ka kontratë me firmën e licencuar për transportimin e mbejtjeve spitalore si dhe kur kanë nuk është evidentuar dokumentacioni i levizjes së mbetjeve si dhe shlyerja e detyrimeve financiare për këtë qëllim.

-Nga inspektori nuk ka shënime në procesverbal dhe në dokumenta të tjera për përshkrime të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011, neni 41” të drejta të tjera të inspektorit.

-Nga auditimi për zbatimin e pikës 3, 4, të neni 45 të ligjit, për përmbajtjen e procesverbalit konstatohet se procesverbalet nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit si dhe nuk shoqërohen me listë-verifikimin e provave gjatë inspektimit. Procesverbalet i inspektimit nuk përmbajnë informacion për të drejtën e subjektit të inspektuar në rast se ka që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Gjithahstu në asnjë rast nuk ka procesverbale ku të shënohen marrja e dokumenteve, fotokopje e lejeve mjedisore të lëshuara nga DRM, dhe prova të tjerë që legjitimojnë vertësinë e inspektimit dhe që konkretisht janë përcaktuar qartë nga ligji.

Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se inspektori në terren nuk është shprehur në lidhje me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren , Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

4. Për z. A. H., me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushen e mjedisit.

Nga auditimi konstatohet se -Subjekti nuk ka njoftim, *veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011.*

- Inspektori është shprehur në procesverbal se ka konstatuar se subjekti ka zbatuar detyrën e lënë nga inspektimi i mëparshëm por pa cituar konkretisht llojin e detyrës. **Në procesverbal nuk ka të dhëna për zbatimin e nenit 48 Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit** pika 5, *në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni dhe pikës 6. Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.*

Në procesverbal nuk ka përshkrime të detajuara sipas kërkesës së formatit tip të tij me aneksin

Në zbatim të autorizimit të inspektimit *nr. 745/1 prot, datë 01.08.2017, nr. 762/1 prot, datë 07.08.2017 në autorizim nuk është shënuar data e kryerjes dhe afati i kohëzgjatjes së inspektimit.*

Nga procesverbali i mbajtur me nr. Serie 0013442 dt 14.08.2017, mbi inspektimin e kryer është konstatuar se objekti i lartpërmendur gjeneron mbetje spitalore në masën 8 kg në muaj dhe ka lidhur kontratë me firmën Me-di tel të vlefshme deri me 31.12.2017.

-Subjektit nuk i janë lënë detyra të tjera për zbatim si mbajtjen e regjistrit të mbetjeve dhe nuk është dhënë gjobë.

-Subjektit nuk i është kërkuar leja mjedisore dhe fotokopja ti bashkangjitej praktikës si provë e inspektimit si dhe të konfirmohet elektronikisht në QHKL dhe ISHMPU për paisjen me Leje medimore

-Sipas autorizimit të inspektimit *nr. 773/3 prot, datë 08.08.2017, inspektori nuk ka shënime në procesverbal rreth marrëdhënieve kontraktuale me firmën për vendin e largimit të mbeturinave, apo për përshkrime të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011, neni 41” të drejta të tjera të inspektorit”.*

-Nga auditimi për zbatimin e pikës 3, 4, të nenit 45 të ligjit, për përmbajtjen e procesverbalit konstatohet se procesverbalet nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit si dhe nuk shoqërohen me listë-verifikimin e provave gjatë inspektimit. Procesverbalet i inspektimit nuk përmbajnë informacion për të drejtën e subjektit të inspektuar në rast se ka që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Gjithashtu në asnjë rast nuk ka procesverbale ku të shënohen marrja e dokumentave, fotokopje e lejeve mjedisore të lëshuara nga DRM, dhe prova të tjerë që legjitimojnë inspektimin dhe që konkretisht janë përcaktuar qartë nga ligji.

Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se inspektori në terren nuk është shprehur në lidhje me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren , Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave

kufi të shkarkimeve” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

b. “Vërejtje me paralajmërim” për 3 punonjësit e sektorit mjedisit, si më poshtë:

1.Për z.D.V., me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushen e mjedisit”.

Ku sipas autorizimeve nr.967/1 prot, datë 19.09.2017, nr. 919/1 prot, datë 06.09.2017, nr.938 prot, datë 11.09.2017,

lidhur me kërkesën që “Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përbashimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj. dhe nenit 24” *Inspektimi i programuar’ pika 1,2,3. - Subjekti nuk ka njoftim, veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit.*

-Nga procesverbali i mbajtura, mbi inspektimin e kryer është konstatuar se subjekti i lartpërmendur nuk është paisur me leje mjedisi të tipit C.

-Nga grupi i inspektimit nuk evidentohet në se ka patur inspektim të mëparshëm dhe sa kohë ka që subjekti ushtron aktivitetin.

-Në autorizim nuk shpjegohen shkaqet të tjera që diktojnë kryerjen e inspektimit.

- Nuk ka bashkëpunim në zbatim të neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë ...” ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për veprimtarinë dhe rezultatet e saj për bashkëpunimin me institucione të tjera si NJQV, DRTT Fier për statusin financiar të subjektit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nga inspektimi cilësohet se subjektet nuk ka kontratë me firmën e licencuar për transportimin e mbejtjeve spitalore si dhe kur kanë nuk është evidentuar dokumentacioni i levizjes së mbetjeve si dhe shlyerja e detyrimeve financiare për këtë qëllim.

-Nga inspektori nuk ka shënime në procesverbal dhe në dokumenta të tjera për përkrahje të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011, neni 41” të drejta të tjera të inspektorit.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

2- Për z. R.M. , me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për mangësitë dhe shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr.9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushen e mjedisit”, ku rezultojnë në disa raste :

-Nuk është bërë njoftim paraprak të subjektit për inspektimin e kryer në zbatim të autorizimit nr. 675, 675/a prot. datë 19.07.2017, nr. 799/1 datë 10.08.2018, nr 803 datë 15.07.2018, nr nr. 843 prot, datë 17.08.2017 .

Nga auditimi konstatohet se -Subjekti nuk ka njoftim, *veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011.*

- Inspektori është shprehur në procesverbal se ka konstatuar se subjekti ka zbatuar detyrën e lënë nga inspektimi i mëparshëm por pa cituar konkretisht llojin e detyrës. **Në procesverbal nuk ka të dhëna për zbatimin e neni 48 Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit** pika 5, në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni dhe pikës 6. *Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjohë, në vlerë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.*

Në procesverbal nuk ka përshkrime të detajuara sipas kërkesës së formatit tip të tij me aneksin 4.

Në zbatim të autorizimit të inspektimit nr. 745/1 prot, datë 01.08.2017, nr. 762/1 prot, datë 07.08.2017 në *autorizim nuk është shënuar data e kryerjes dhe afati i kohëzgjatjes së inspektimit.*

Nga procesverbalet e mbajtur me nr. Serie mbi inspektimin e kryer është konstatuar se objekti i lartpërmendur gjeneron mbetje spitalore me sasi të përcaktuar për cdo muaj dhe ka lidhur kontratë me firmën Me-di tel të vlefshme deri me 31.12.2017 por subjekteve nuk i janë lënë detyra të tjera për zbatim si mbajtjen e regjistrit të mbetjeve dhe nuk është dhënë gjobë.

-Sipas autorizimit të inspektimit nr. 773/3 prot, datë 08.08.2017, inspektori nuk ka shënime në procesverbal rreth marrëdhënieve kontraktuale me firmën për vendin e largimit të mbeturinave, apo për përshkrime të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011, nenit 41”të drejta të tjera të inspektorit

-Subjekteve nuk i është kërkuar leja mjedisore dhe fotokopja ti bashkangjitej praktikës si provë e inspektimit si dhe të konfirmohej elektronikisht në QHKL dhe ISHMPU për paisjen me Leje medisore.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

3. Për z. E.Sh. , me detyrë, Përgjëgjës i sektorit të Mjedisit , për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi në fushen e mjedisit”.

nr.810 prot, datë 14.08.2017,

Nga auditimi konstatohet se -Subjekti nuk ka njoftim, *veprim në moszbatim të Kreu V-seksioni 1, neni 32 ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011.*

- Inspektori është shprehur në procesverbal se ka konstatuar se subjekti ka zbatuar detyrën e lënë nga inspektimi i mëparshëm por pa cituar konkretisht llojin e detyrës. **Në procesverbal nuk ka të dhëna për zbatimin e nenit 48 Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit** pika 5, *në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni dhe pikës 6. Mos korigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.*

Në procesverbal nuk ka përshkrime të detajuara sipas kërkesës së formatit tip të tij me aneksin 4.

Në zbatim të autorizimit të inspektimit nr. 745/1 prot, datë 01.08.2017, nr. 762/1 prot, datë 07.08.2017 në *autorizim nuk është shënuar data e kryerjes dhe afati i kohëzgjatjes së inspektimit.*

Nga procesverbalet e mbajtur me nr. Serie 0013501 dt 1.08.2017, mbi inspektimin e kryer është konstatuar se objekti i lartpërmendur gjeneron mbetje spitalore në masën 8 kg në muaj dhe ka lidhur kontratë me firmën Me-di tel të vlefshme deri me 31.12.2017.

-Subjektit nuk i janë lënë detyra të tjera për zbatim si mbajtjen e regjistrit të mbetjeve dhe nuk është dhënë gjobë.

-Subjektit nuk i është kërkuar leja mjedisore dhe fotokopja ti bashkangjitej praktikës si provë e inspektimit si dhe të konfirmohej elektronikisht në QHKL dhe ISHMPU për paisjen me Leje medisore

-Sipas autorizimit të inspektimit nr. 773/3 prot, datë 08.08.2017, inspektori nuk ka shënime në procesverbal rreth marrëdhënieve kontraktuale me firmën për vendin e largimit të mbeturinave, apo për përshkrime të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo forma tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011, nenit 41”të drejta të tjera të inspektorit”.

-Nga auditimi për zbatimin e pikës 3, 4, të nenit 45 të ligjit, për përmbajtjen e procesverbalit konstatohet se procesverbalet nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit si dhe nuk shoqërohen me listë-verifikimin e provave gjatë inspektimit. Procesverbalet i inspektimit nuk përmbajnë informacion për të drejtën e subjektit të inspektuar në rast se ka që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Gjithahstu në asnjë rast nuk ka procesverbale ku të shënohen marrja e dokumentave, fotokopje e lejeve mjedisore të lëshuara nga DRM, dhe prova të tjerë që legjitimojnë inspektimin dhe që konkretisht janë përcaktuar qartë nga ligji.

Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se inspektori në terren nuk është shprehur në lidhje me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren, Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, nenit 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi”

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektori nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar (të vjetër).

4-Për z.A. B., me detyrë Kryeinspektor, për periudhën e audituar, nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte “**Vërejtje**”, por kjo mase quhet ezauruar pasi është ulur në detyrë si Përgjegjës i Sektori të Mjedisit.

5.Për znj. 1. znj. S. J., me detyrë Specialiste Finance, për mangësitë e shkeljet lidhur me hartimin ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit, trajtuar në Raportin përfundimtar të Auditimit faqe 14-17 të Akt-konstatimi nr. 1, datë 26.12.2018, *nuk propozojmë mase duke qene se mangësitë janë të ndërvarura nga strukturat e Financës së ISHMPU.*

C.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit” i ndryshuar, **i rekomandojmë Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë,** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.10.2016 deri më 01.10.2018, i lihet në kompetencë përcaktimi i llojit të masës dhe të fillojë procedurat për dhënie e masës disiplinore, nga “**Vërejtje me paralajmërim**” deri në “**ndërprerje të kontratës së punës**”, për **9** punonjësit si më poshtë:

Sektori i Policisë Pyjore për 9 punonjës marrëdhënie me kontratë.

1.Për z.I.K., me detyrë Përgjegjës sektori i Pyjeve Mallakastër prej datës 14.9.2016, për mangësitë e shkeljet trajtuar në Akt-konstatimi nr. 8, datë 17.01.2019, nr.7, datë 17.01.2019,

nr. 5, datë 15.01.2019 dhe faqet 79-100, 100-102 dhe 102-109 të Raportit Përfundimtar të auditimit

2.Për z. E. L., me detyrë inspektor prej Prill 2018 Përgjegjës Sektori Pyjesh sektori Lushnjë për mangësitë e shkeljet trajtuar në Akt-konstatimi nr. 8, datë 17.01.2019, nr. 5, datë 15.01.2019 dhe në faqet 79-100 ,fq.102-109 të Raportit Përfundimtar të auditimit

3. Për z. A. T., me detyrë inspektor pyje sektori Lushnjë për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr. 8, datë 17.01.2019, nr. 5, datë 15.01.2019 dhe në faqet 79-100 ,fq.102-109 të Raportit Përfundimtar të auditimit

4. Për z. A. Q., me detyrë inspektor pyje sektori Fier, për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr. 8, datë 17.01.2019, nr. 5, datë 15.01.2019 dhe në faqet 79-100 ,fq.102-109 të Raportit Përfundimtar të auditimit

5. Për z. P. S., me detyrë inspektor në sektorin e pyjeve Fier për mangësitë e shkeljet trajtuar Akt konstatimi nr. 8, datë 17.01.2019 faqet 79-100 Raportit Përfundimtar të auditimit

6. Për z. D. K., me detyrë inspektor në sektorin e pyjeve Fier për mangësitë e shkeljet trajtuar në Akt-konstatimi nr. 8, datë 17.01.2019 faqet 79-100 të Raportit Përfundimtar të auditimit

7. Për z. V. M., me detyrë inspektor në sektorin e pyjeve Lushnjë për mangësitë e shkeljet trajtuar në Akt konstatimi nr. 8, datë 17.01.2019 faqet 79-100 të Raportit Përfundimtar të auditimit

8. Për z. R. K., me detyrë inspektor pyjesh në sektorin Mallakastër prej 20.03.2018 aktualisht transferuar për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr. 7, datë 17.01.2019 në fq 100-102 të Raportit Përfundimtar të auditimit

9.Për z. D. H. , me detyrë ish-Përgjegjës Sektori Pyjesh sektori Lushnjë deri Prill 2018, aktualisht ne ISHMPUT Tiranë, për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr. 8, datë 17.01.2019, nr. 5, datë 15.01.2019 në faqet 79-100 ,fq.102-109 të Raportit Përfundimtar të auditimit

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për punonjësit e larguar nga puna *nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës .*

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte **“Largim nga Sherbimi civil”**.

1.Per z. B. P., me detyrë përgjegjës i Sektorit te Mjedisit për periudhën 21.02.2014 deri me date 20.03.2017 për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushën e mjedisit”.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte **“Largim nga Sherbimi civil”**.

2.Për z. O. K. , me detyrë përgjegjës i Sektorit te Mjedisit nga data 18.05.2017 deri ne 12.12.2017 për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 9-10 datë 17.01.2019 “Inspektimi ne fushën e mjedisit

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R